



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevë / Municipality- Malisheve



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE / SKUPSHINA OPSTINE MALISHEVO



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON 27-09-2012
PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 02 / 2012

RREGULLORE PËR TATIMIN
MBI PRONËN E PALUAJTSHME

(Për vitin 2013)

Shtator -2012

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 03/L-204** të datës 7 tetor 2010 të Parlamentit të Kosovës, dhe Ligjit Nr. 03L/0-40 për vetëqeverisje lokale, Statutit të Kuvendit Komunal të Malishevës, Asambleja Komunale në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____, aprovon këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni 1.

1. Duke u bazuar në Nenin 6 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme**, baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Destinimi i objektit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
Prona rezidenciale-shtëpi	300€	250€	200€	170€
Prona rezidenciale-banesë	350€	300€	250€	200€
Prona të paperfunduara				
Prona industriale	250€	220€	200€	200€
Prona komerciale	550€	350€	280€	200€
Prona bujqësore	180€	150€	150€	150€
Pronat e braktisura	150€	120€	100€	50€
Fushat sportive dhe pishina	100€	80€	60€	40€

Neni 2.

1. Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr.3/2011, nenin 5 dhe pikën 1.8.1, do të llogaritet edhe koeficienti i kualitetit (gjendejes) të ndërtesës.

Neni 3.

1. Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Malishevës janë përcaktuar katër zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 4.

1.1 Zona e parë përfshin të gjitha banesat, shtëpi dhe lokale afariste që gjenden përkaj rrugës “Adem Jashari”, “Skënder Beu”, “Imer Krasniqi” dhe “Rilindja Kombëtare” në largësi deri në 200 m nga rrugët kryesore në Malisheve.

1.2 Zona e dytë përfshin të gjithë shtëpitë dhe objektet afariste të cilat janë në brendi të qytetit. Në largësi prej 200 metra jashtë zonës së parë. Si dhe zonën urbane në Banjë dhe zonën urbane në Kijevë.

1.3 Zona e tretë përfshinë fshatrat: Balincë, Tërpeze e Ulet, Carrallukë, Drenoc, Kijevë- zona jo urbane, Bubavec, Lubizhde, Mirushe, Dragobil, Astrazup, Maxharre, Bellanice, Banje, Mleqan Llazice dhe Temeqinë.

1.4. Zona e katërt përfshin fshatrat rurale të Komunës së Malishevës: Guncat, Bardh, Senik, Lladroc, Terpeze, Berishe, Kervasari, Guriq, Pagarushe, Shkoze, Marali,

Neni 5.

1. Në pajtim me neni 7 të **Ligjit Nr. 04/L-100 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme**, normat tatimore të tatimit në prone për vitin tatimor 2012 për Komunën e Malishevës janë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.15%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.15%
3.	Prona industriale	0.15%
4.	Prona komerciale	0.15%
5.	Prona bujqësore	0.15%
6.	Pronate braktisura	0.15%

Neni 6.

1. Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura në nenin 8 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e paluajtshme**, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Malishevës

Neni 7.

1. Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 16 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronën e paluajtshme**.

Neni 8.

1. Në pajtim me nenin 22 të **Ligjit Nr. 03/L-204 mbi tatimin në Pronën e paluajtshme** mbi përgjegjësitë komunale, Kryetari i Komunës së Malishevës emëron Bordin e Pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2013 .

Neni 9.

1. **Ligji Nr. 03/L-204** i datës 7 tetor 2010 dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 10.

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Asamblesë komunale dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2013.

Më: 27/09/2012

Malishevë



Kryesuesi i Asamblesë Komunale

Ragip Begaj